



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-7152/24 datë: 19.03.2024



Npi – 01/109 datë: 26.03.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 26.03.2024 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -III- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 26.03.2024 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrushë, znj.Adelina Beqaj, znj.Sanije Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; znj.Yllka Fejzullahu drejtoreshë e DKA; z.Bardhyl Rushiti drejtor i DSHP; z.Valon Januzi drejtor i DPA; z.Besnik Ahmeti drejtor i DBF; Nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni dhe znj.Donjeta Qorrolli praktikante, znj.Gentiana Mehmeti asistente e Kryesuesit të Kuvendit; dhe znj. Valmira Hoxha praktikante.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 23.02.2024,
2. Propozim-Vendim për ndrrimin e destinimit të ngastrave në ZK-Davidovc,
3. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01-190 për Çerdhen në Petrovë,
4. Propozim-Vendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë NPKSH “Higjena” dhe “Kryqit të Kuq të Kosovës” në Shtime,
5. Pasqyrat Financiare për vitin 2023,
6. Propozim-Vendim për miratimin e vlerësimit të dëmeve të FN&FT për Janar-Tetor 2023,
7. Draft-Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për 2022-2024 (diskutim publik)
8. Prop-vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e titujve “Sakrifica Reçakut-1999” dhe “Pena e Artë”.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 23.02.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 23.02.2024.**

Pika 2

Propozim-Vendim për ndërrimin e destinimit të ngastrave në ZK-Davidoc,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha z.Grejtalb Eminin.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, kemi kërkesë për fshatin Davidoc që ka të bëjë me zgjerimin e varrezave të fshatit. Materialin e keni marrë dhe besoj e keni lexuar, për sa u përket detajeve, unë kërkoj që me përkrah këtë kërkesë për zgjerimin e varrezave të fshatit Davidoc.

z.Përparim Ramusa; E falenderoj drejtorin për këtë propozim, nga aspekti ligjor është në rregull kështu që ne jemi për miratim.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndërrimin e destinimit të ngastrave në ZK-Davidoc.**

Pika 3

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01-190 për Çerdhen në Petrovë

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha znj.Yllka Fejzullahut, për prezantimin e kësaj pike.

znj.Yllka Fejzullahu, drejtoresh e DKA; Përshëndetje, materialin e keni marrë, dhe siç keni mundur ta shihni, ne e kemi një kërkesë nga Ministria e Arsimit për zgjerimin e hapsirës nga 7 ari të bëhet në 15 ari për ndërtimin e Çerdhes në fshatin Petrovë, sepse siq e kanë konstatuar ata hapsira prej 7 ari nuk mjafton, kështu që tani ne po kërkojmë nga Kuvendi që kjo sipërfaqe të zgjerohet në 15 ari, sepse është e domosdoshme. Ju ftoj që ti rekomandoni Kuvendit miratimin e këtij vendimi.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Është mirë me u rritë hapsira, sepse kemi rekomandim nga Ministria për Arsim, por kjo është edhe në interes të fëmijëve që të kenë hapsirë më të madhe.

z.Përparim Ramusa; Në emër të grupit ne do ta votojmë, por po besoj se pas kësaj nuk na thuani nuk e keni votuar. Ju e keni vonuar për pa dituri dhe neglizhencë.

znj.Yllka Fejzullahu, drejtoresh e DKA; Nuk është për shkak të paditurisë, por për shkak të procedurave që duhet të zbatohen siç e kërkojnë normat e (UNICEF-it).

z.Përparim Ramusa; Ne do ta votojmë, por ne komunikojmë me ju e jo me Ministrinë.

znj.Adelina Beqa; Edhe unë jamë "Për", ne e kemi diskutuar këtë çështje, dhe ka pas diskutime të shumta që aty gjenden varreza, dhe tani nëse zgjerohet hapsira aty atëherë do të preken varrezat. Arsyetimi i drejtoreshës ishte i pa saktë, sepse siç e dimë atëher ka qenë edhe Çerdhja e Godancit.

z.Kadri Emini; Ne duhet me e mbështetë këtë projekt sepse është i mirë, e sa i përket 7 ari ne edhe atëherë me pas mujtë i kishim ndarë 15 ari, por ka pas problem me çështjen e varrezave aty, por sidoqoftë do ta përkrahim.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndryshimin e vendimit të Kuvendit Npi-01-190 për Çerdhen në Petrovë.**

Pika 4

Propozim-Vendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë NPKSH "Higjena" dhe "Kryqit të Kuq të Kosovës" në Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Grejtalb Eminin.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Objekti i administratës komunale do të ndërtohet por sipërfaqja aty ku po planifikojmë të ndërtohet është e ish Kompanisë Publike "Higjena" si dhe një pjesë e "Kryqit të Kuq". Ish Kompania Publike "Higjena" e cila tani thirret KRM "Pastërtia" aty ka një objekt, ndërsa "Kryqi i Kuq" nuk ka kurrfar objekti. Këtyre dy subjekteve Komuna ua ka dhanë në shfrytëzim të përkohshëm këto paluajtshmëri, të cilat po besoj i keni pa në materialion që ua kemi dërguar. Tani po na paraqitet nevoja për me ua marrë këtë të drejtë këtyre shfrytëzuesve, për interes publik, ndërtimi i objektit të Komunës. Ne kemi biseduar edhe me "Pastërtinë", dhe bashkërisht do ta caktojmë lokacionin për KRM "Pastërtia". Lokacioni i kompanisë publike të mbeturinave nuk duhet të jetë aty, sepse është para Shkollës, Policisë, dhe objekteve tjera publike atje. Përpara mbase ka qenë e arsyeshme, mirëpo tani ajo zonë është mbuluar me objekte të rëndësishme publike, si dhe zona rekreativo-sportive, ku aty është parku i pishave shumë afër.

z.Kadri Emini; A mendon që duhet të ju bëhet zgjidhje ish "Higjenës" paraprakisht? Apo do të bëhet zgjidhje pas marrjes së vendimit.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Këto të dyja janë pjesë e jona, dhe nuk është se ne do ti largojmë në mënyrë arbitrare, por gjithsesi do të gjejmë zgjidhje.

znj.Adelina Beqa; Unë mendoj se është dashtë të bëhet një zgjidhje paraprakisht, dhe e dyta si qëndron puna me PZHK-në (Planin Zhvillimor Komunal)?

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Neve fillimisht na duhet vendimi për me i filluar procedurat. Kjo është paraparë si zonë për ndërtimin e objekteve publike për sa i përket PZHK-së.

z.Përparim Ramusa; Mendoj se është hap i ngutshëm pa bërë zgjidhje për KRM “Pastërtinë”. Tjetër, që një vit e gjysmë nuk keni bërë asnjë hap sipas marrëveshjes me Ministrinë. Unë jam “Kundër” në formën qysh e keni pru këtu.

znj.Adelina Beqa; Tendenca juaj është për me shuar “Pastërtinë”, kjo shihet edhe sipas vendimit për themelim të kompanisë publike. Kështu nuk e pranojmë pa bërë zgjidhje.

z.Valon Januzi, drejtor i DAP; Tani veq janë të koduara 2.5 milion euro për ndërtimin e objektit të ri të Komunës së shtimes, dhe për këtë Kryetari ka nënshkruar Marrëveshje për Bashkëfinancim me Ministrinë e Punëve të Brendëshme. Ne jemi të obliguar që ta sigurojmë lokacionin më të përshtatshëm për objektin e komunës.

z.Përparim Ramusa; Objekti ka pas me filluar në vitin 2023 e që nuk ka filluar sipas memorandumit.

znj.Zejnije Veliu; Përshëndetje, të gjithë e dimë se është i domosdoshëm ndërtimi i objektit të ri të Komunës. Unë mendoj se për kompaninë duhet të bëhet zgjidhja, sidomos për makinerinë e rëndë sepse është më problem. Deri sa ne jemi anksionarë nuk mundet KRM “Pastërtia” me u zhdukë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë NPKSH “Higjena” dhe “Kryqit të Kuq të Kosovës” në Shtime.**

Pika 5

Pasqyrat Financiare për vitin 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF; Përshëndetje ne kemi obligim ligjor që me paraqitë informatë në Kuvend për pasqyrat financiare për vitin 2023. Në vazhdim lexoi informatën sipas tabelave dhe kodeve buxhetore (shih dokumentin).

z.Përparim Ramusa; Faleminderit për informatën, sipas kësaj që po shohim shpenzimet kontigjente janë 500,000 euro, e që po besoj se janë te arsimit, mirëpo nuk po e kuptoj pse mjetet me shku nga pagat dhe mëditjet.

z.Besnik Ahmeti, DBF; Përmabruesi na i merr mjetet aty ku i gjenë.

Pika 6

Propozim-Vendim për miratimin e vlerësimit të dëmeve të FN&FT për Janar-Tetor 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Fjalën ja dha Bardhyl Rushitit.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Përshëndetje ne e kemi propozuar këtë vendim sepse na është kërkuar nga Ministria. Ne i kemi paraqitë të gjitha të dhënat. Materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, kështu që unë nuk do ta zgjati vetëm ju ftoj që ta miratoni. Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

znj.Albulena Emini, Kryetare e Komisionit Vlerësues; Përshëndetje sipas normativës jemi obliguar që këtë vlersim të dëmeve ta kalojmë në Kuvend. Fatmirësisht kjo përpara nuk ka ndodhë. Ne si Komision kemi dalë në teren si ekip dhe kemi bërë vlerësimet e dëmeve, për këtë kemi bërë një listë të personave që janë prekur nga këtë dëme. Listën e keni marrë dhe e keni pa kështu që nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Pse nuk është bërë pagesa më herët, kur disa Komuna i kanë paguar. Dhe një arsyeshmëri për dëmet e shkaktuara a janë bërë nga operatori ekonomik.

znj.Albulena Emini, Kryetare e Komisionit Vlerësues; Ky është raporti i vitit 2023. Ne e kemi dërguar raportin në Ministrinë e Financave, dhe neve na është kthyer në muajin Dhjetor, dhe arsyetimi na është dhënë sepse disa komuna sikurse ajo e Skenderaj e Pejë kanë pasë dëme shumë më të mëdha. Dhe më vonë kanë kërkuar që vlerësimi i dëmeve me kaluar në Kuvend. Është kërkuar

Ilogaria bankare për të gjithë, ne i kemi kërkuar dhe i kemi siguruar llogaritë bankare. Sa i përket shkaktarit të dëmit, mund të ju them se intervenimi ka qenë vullnetarisht prej KFOR -it, e që tani ne nuk mundë të kërkojmë kompensim prej KFOR-it.

z.Përparim Ramusa; Te punimet në Lum jemi të qartë, ndërsa te përgjigja e parë nuk jamë i kënaqur, mirëpo do të debatojmë në Kuvend. Ne jemi “Për”.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për miratimin e vlerësimit të dëmeve FN&FT për Janar-Tetor 2023.**

Pika 7

Draft-Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për 2022-2024 (diskutim publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për diskutim publik të Plani lokal i veprimit për komunitetet Rom e Ashkali për periudhën 2022-2024. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pika 8

Prop-vendim për formimin e Komisioneve për ndarjen e titujve “Sakrifica Reçakut-1999” dhe “Pena e Artë”.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Mendoj se jemi të qartë te kjo pikë sepse kemi të bëjmë me rastin e njejt me vendimet e miratuara nga mbledhja e kaluar për ndarjen e çmimeve “Qytetar Nderi” dhe “Nderi i Qytetit”, kështu që vetëm po kërkojmë nga Ekzekutivi që ti sjellë në Kuvend emrat e anëtarëve të Komisionit.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për formimin e Komisioneve për ndarjen e titullit “Sakrifica Reçakut -1999” dhe çmimin “Pena e Artë”, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve, me kërkesën që në Kuvend të sillen emrat nga ekzekutivi dhe shoqëria civile.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 15:12h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

